



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2182 Prot.

Roskovec, më 26, 03 2024

V E N D I M

Nr. 20, datë 25/03 /2024

"PËR MIRATIM FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2024"

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54 pika ç dhe dh , të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjen vendore" neni 45 të tij , Udhëzimi nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", pika 103, të VKB nr.109 datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetit , numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse për vitin 2024" si dhe materjaleve të paraqitura nga Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Projekteve me BE dhe Marrdhëniet me Publikun; Këshilli i Bashkisë,

-VENDOSI :

- I. Të miratojë fondin prej **2,402,035 lekë** për bashkëfinancimin për projektin "Bujqësia e qëndrueshme dhe ndryshime klimatike: ndikimet strategjitë dhe veprimet zbutëse" SuS-AGRI. Fondi të përballohet nga zëri "Kontribute për projekt. me bashkfinanc. me donator vendas" të përcaktuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2024.
- II. Të miratojë fondin prej **1,691,280 lekë** për bashkëfinancimin për projektin "Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të bashkive të Adriatikut Jugor përmes miratimi të një plani të përbashkët veprimi ndërkufitar dhe shkëmbimit të praktikave më të mira në lidhje me Konventën e Kryetarëve" ADRICOM. Fondi të përballohet nga zëri "Kontribute për projekt. me bashkfinanc. me donator vendas" të përcaktuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2024.
- III. Të miratojë fondin prej **57,420 lekë** për pagesën e detyrimeve si anëtare në Shoqatën Evropiane për Demokracinë Lokale ALDA.
- IV. Ngarkohet Administrata e Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka